



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**  
**GJIROKASTËR**

**SENATI AKADEMIK**

00355 842 63408

e-mail: [rektori@uogj.edu.al](mailto:rektori@uogj.edu.al)

[http www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al)

Gjirokastrë, më 27.06.2017

**VENDIM**

**Nr. 21 datë 27.06.2017**

Në mbështetje të propozimeve nga Dekanët e fakulteteve të Universitetit "Eqrem Çabej"  
"Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.06.2017 me votim unanimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë çeljen e 2 (dy) datave shtesë për studentët e vitit të fundit në të gjitha programet e studimit të Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë në format e studimit me kohë të plotë dhe kohë të zgjatur të cilët kanë detyrime të pashlyera.

Mbështetur në Nenin 51 të Rregullores së Brendshme të Universitetit përjashtohen të hyjnë në këto data studentët,

a - të cilët kanë hyrë në provimin e një disipline brenda sezonit të verës dhe janë vlerësuar negativisht .

b - studentët që nuk e kanë frekuentuar atë disiplinë / modul gjatë vitit .

Prof.dr.Bekdash MEMA

**KRYETAR I SENATIT**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

Gjirokastrë, më 08. 06. 2017

Nr 16 Prot

**Lënda:** Kërkohen 2 data shtesë për studentët në prag të diplomimit.

**Drejtuar:** Rektorit të UGJ


**Këtu**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë propozimin e përgjegjësive të departamenteve të FESHSH për 2 data shtesë për studentët e vitit të III të ciklit të parë Bachelor dhe të vitit të II ciklit të dytë Master Profesional dhe Master Shkencor.

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!*

Prof.dr Gëzim SALA

**DEKAN**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR

Gjirokastrë, më 08. 06. 2017

**Lënda:** Kërkohen 2 data shtesë për studentët në prag të diplomimit.

**Drejtuar:** Dekanit të FESHSH.

**Për dijeni:** Rektorit të UGj

**Këtu**

I nderuar zoti Dekan!

Për arsye të ndryshme objektive mjaft studentë të vitit të III të ciklit të parë Bachelor dhe të vitit të II ciklit të dytë Master Profesional dhe Master Shkencor, kanë pa shlyer deri në 2 provime dhe janë në prag diplomimi.

Meqënëse pritet të hartohet Statuti dhe Rregullorja e re e studimeve propozojmë që për këtë kategori studentësh të shpallen 2 (dy) data shtesë provimesh në periudhën 26 Qershor - 03 Korrik 2017 me qëllim pajisjen e tyre me diplomë në sezonin e verës.

Mbetemi me shpresë se kërkesa jonë do të merret në konsideratë nga ana juaj.

1. Përgj.dep. Historisë

Prof. Asoc. Jaho Cana

2. Përgj.dep. Gjeografisë

Prof. Asoc. Albina Sinani

3. Përgj.dep. Gjuhë Shqipe

Prof. Asoc. Spiridhulla Poçi

4. Përgj.dep. Letërsi

Prof. Asoc. Merita Shehu

5. Përgj.dep. Administrim Publik

Prof. Asoc. Ermonela Ruspi

6. Përgj.dep. DEMM

Prof. Dr. Liljana Reçka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Gjirokastrë, më 16.06.2017

Nr. 253 Prot.

**Lënda:** Propozim për çelje datash provimi shtesë për sezonin e verës.

**Drejtuar:** Rektorit

*Prof. Dr. Bektash Mema*

**K Ë T U**

Bazuar në kërkesat e studentëve të viteve të treta (të fundit) të programeve të cilit të parë të të studimeve (Bachelor) si dhe propozimet e përgjegjësve të Njësive Bazë të FSHN-së; ju propozojmë çeljen e datave shtesë të provimeve në të gjitha programet e studimit të ciklit të I (parë) si dhe në të dy sistemet e studimit (kohë e plotë , kohë e zgjatur) që mbulon FSHN.

Këto data të jenë maksimumi deri në dy data në sezonin e verës për vitin akademik 2016-2017 ku përfshihen të gjitha detyrimet e pashlyera përjashtoj ato detyrime që bien ndesh me *Nenin 51 të Rregullores së Brendshme të Universitetit " Studentit nuk i lejohej të hyjë në më shumë se një herë në provimin e një disipline brenda të njëjtë sezon "*.

*Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi*

**DEKAN**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**  
**FAKULTETI EKONOMIK**

Nr.52 Prot.

Gjirokastrë, më 03.08.2020

**Lënda:** Çelje datë provimi.

**SEKRETARISË MËSIMORE**  
**KËTU**

Albana Kótroci studente e regjistruar në vitin akademik 2018-2019 në programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në Administrim Publik me kohë të plotë, për arsye objektive studentja e sipërpermendur nuk u paraqit në datat e interpelancës. Për arsye objektive dhe bazuar në kërkesën e saj të lejohet të hyjë në provimin e disipline "Komunikim dhe marrëdhënie me publikun" në dt. 04/08/2020.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Përgjegjës i Dep. të Administrim Publik  
Doc.Dr. Alketa Bejko

Miratohet  
Zv. DEKANI



## Mërkese

Une e mërkture Albanët do të përfaqësojnë  
shëndetësore nuk janë parafunduar në ditë e  
Interpellancës për të zhvilluar provimin.  
Mërkaj që ta shpallë në një datë jetën.  
Shprehëse që kërkesa ime të mirë  
parasysh.

Albana Përkaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS  
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS, INFORMATIKËS DHE FIZIKËS**

Nr. 65 prot.

Gjirokastër, më 14.10.2020

**Lënda:** Zëvendësim anëtar komisioni.

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS**

**Këtu**

Në mungesë për arsye objektive të pedagogut Roland Vasili si anëtar në komisionin e provimit të lëndës "Sisteme Operative" në programin e studimit të Ciklit të Parë, "Bachelor në Teknologji Informacioni", me kohë të plotë, në bazë të Nenit 33 të Rregullores së Universitetit kërkoj zëvendësimin e tij me pedagogun Kosta Lili.

**PËRGJEGJËS I NJËSISË BAZË**

**Dr. Dhoris Terpo**

**MIRATOI  
DEKAN**

**Prof.Asoc.Dr. Selfo Oruçi**

